



Procesverbal 12/2023

I mbajtur në mbledhjen e XII - të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e z.Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën **14.12.2023** në ora **10:00**.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Takim me Drejtorinë e Infrastrukturës, lidhur me projektin e infrastrukturës me Lagjen “ Halit Ibish”, Sallahane dhe Fshatin Dubravë të detajuara me buxhet dhe afat kohor;
5. Takim me Drejtorin e Shërbimeve publike dhe emergjencë lidhur me nevojat e shenjave të komunikacionit etj. dhe
6. Të ndryshme.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Hapi mbledhjen;

Pika 2

Aprovohet Rendi i Ditës.

Pika 3

Aprovohet procesverballi i mbledhjes së kaluar.

Pika 4

Drejtori i Infrastrukturës ; Sa i përket projekteve kam shumë projekte në rrugët ku janë minoritetet, është fërfunduar rruga dytësore Dubravë, kemi pas projekt ku rrugicat janë shtruar në Lagjen “Halit Ibish”, Dubravë, “Sallahane”..

Disa nuk kanë mund të shtrohen se kanë kërku kopenzim.

Në Lagjen “Sallahane”, në rrugën “Ejup Statovci” kanë mbështetje por rikonstruktimi i rrugës do të bëhet edhe sinjalizimi dhe shenjzimi.

Në pranëverë do të përfundohen rrugicat e mbetura.

Në fshatin Dubravë duhet të rregullohet kanalizimi, mirëpo kontratat ose kompanit nuk aplikojnë në fonde dhe tenderi anulohet.
Shpresojmë se një të ardhme të afërt do të rregullohet.
Për trafo, kam biseduar me KEDS-in , ka kërkuar një parcelë për vendosjen e saj në bashkëpunim me Këshilltarin e ministrisë.

Pika 5

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe emergjencë,

Të vendoset retrovizor,
Tek rruga “Ahmet Hoxha” janë afro 1000 nxënës që frekuentojnë në atë rrugë, të ndalohet vend parkimi.

Rruga “Imri Halili”- nja ashtu duhet të ndalohet parkimi i veturave.
Të vendoset retrovizor te rrugica “Beteja e Kaçanikut”.

Floriqe Islami - Të bëhet shenjzimi në rrugën “Enver Topalli”.

Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete – Të organizohet takimi i fund vitit, por jo të jetë vetëm drekë, por të behet planifikimi i Planit të Punës të Komitetit ose dështimet e KK-së.

Procesmbajtësi

O. Emini

Osman Emini



Kryesuesi i komitetit për komunitete

O. Emini
Osman Emini